

KONTAKTE MË TË RËNDËSISHME:

Ministria e Drejtësisë

📍 st. „Ministria e Drejtësisë“ 9,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
✉ cabinet@justice.gov.mk
☎ +389 (0)2 3116 - 493
☎ +389 (0)2 3116 - 648

Komisioni për kompensim në të holla

🌐 www.komisijazanadomestoknazrtvi.mk
✉ contact@komisijazanadomestoknazrtvi.mk
☎ +389 2 3116 493 lok.119

Personi i kontaktit **Andrijana Gjorgjevska**,
Udhëheqëse e Njesisë për falje
dhe kompensim të dëmit

☎ +389 2 3116 493 lok.119
☎ +389 (0)70 314-453,
✉ agjorgjevska@justice.gov.mk

E DREJTA PËR KOMPENSIM NË TË HOLLA PËR VIKTIMAT E VEPRAVE PENALE ME DHUNË NË MAQEDONINË E VERIUT



Kjo fletëpalosje u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Përmbytja e tij është përgjegjësi vetëm e autorit(ve). Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian apo të Këshillit të Evropës.

SQI

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku djeten, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t' i ndajë arritet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu

Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 46 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

www.coe.int

1

KUSH KA TË DREJTË PËR KOMPENSIM TË DËMIT?

Nëse jeni viktimë e veprës penale me dhunë, duke përfshirë edhe **dhunën me bazë gjinore, dhunën në familje, dhunën kundër integritetit gjinor, trafikimin e qenieve njerëzore/fëmijëve, skllavërinë** ose veprat të tjera penale me pasoja të rënda, si fizike dhe psikologjike, keni të drejtë për kompensim në të holla.

E drejta e kompensimit në të holla vlen edhe për ata që u përpoqën të parandalonin kryerjen e një veprë të tillë, si dhe për ata që ndihmuan viktimën ose ndihmuan policinë në arrestimit të kryerësit të veprës. Kompensim mund të kërkohej gjithashtu edhe nëse **jeni anëtar i familjes së viktimës** e cila ka vdekur për shkak të dhunës.

2

CILI ËSHTË PARAKUSHTI?

Vepra penale të ketë ndodhur në Maqedoninë e Veriut dhe të jetë e **evidentuar ose e raportuar në polici ose prokurorinë publike** të cilët duhet të lëshojnë njoftim përkatës (**vërtetim, shënim zyrtar**).

Kjo e drejtë vlen pavarësisht nga statusi ose shtetësia juaj, me kusht që të gjendeni në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut gjatë kohës së kryerjes së veprës penale. Të drejtë për të kërkuar dëmshpërblim kanë shtetasit e Maqedonisë së Veriut, shtetasit e huaj¹, personat pa shtetësi ose personat e paevidentuar në librin amë të të lindurve.

E drejta e kompensimit vlen edhe nëse kryerësi **nuk është i njohur** ose **nëse nuk ka procedurë penale**.

3

ÇFARË LLOJI DHE ÇFARË SHUME TË KOMPENSIMIT?

Kompensimi në të holla përfshin:

- ▶ shpenzimet për shërim dhe pajisje mjekësore (shuma maksimale deri në 2,000 euro);

- ▶ të ardhurat e humbura (shuma maksimale deri në 2,000 euro);
- ▶ shpenzimet e varrimit (vetëm nëse nuk i keni arkëtuar të njëjtat në një bazë tjetër);
- ▶ mirëmbajtjen e humbur (shuma maksimale prej 4,500 euro); dhe
- ▶ ndihmë solidariteti për pasojat e pësuar nga vepra penale (shuma maksimale deri në 500 euro)

SHUMA E PËRGJITHSHME NUK MUND TË KALOJË 5,000 EURO NË VLERË TË DENARIT.


4

KUJT T'I DORËZOHET KËRKESA PËR KOMPENSIM?


Dorëzoni kërkesë me shkrim drejtpërdrejt nëpërmjet arkivit të Ministrisë së Drejtësisë, me postë ose në formë elektronike drejtuar:


KOMISIONIT PËR KOMPENSIM NË TË HOLLA


Kontakt: Ministria e Drejtësisë

 rr. Dimitrie Chupovski nr. 9,

1000 Shkup

 www.komisijazanadomestoknazrtvi.mk

 contact@komisijazanadomestoknazrtvi.mk

 +389 2 3116 493 lok.119

Nëse jeni viktimë fëmijë ose person me paaftësi veprimi, kërkesa mund të parashtruhet nga prindi, kujdestari ose nga autorizuesi.

Ekzemplari – Formulari i Kërkesës për realizimin e kompensimit në të holla të viktimave nga vepra penale me dhunë mund të shkarkohet dhe të printohet nga ueb faja e Komisionit.

5

CILAT TË DREJTA I KENI GJATË PROCEDURËS?

- ▶ **të drejtë për ndihmë juridike falas**, duke përfshirë këtu edhe për plotësimin e kërkesës për realizimin e kompensimit në të holla.
- ▶ në këtë procedurë **nuk paguhen taksa administrative**.
- ▶ **të drejtë për përkthyes gjatë** gjithë procedurës, ndërsa shpenzimet mbulohen nga shteti (për shtetasit e huaj/personat pa shtetësi).
- ▶ **ndalohet çdo lloj dhe forme e diskriminimi**.²
- ▶ realizimi i të drejtës për kompensim me këtë kërkesë nuk e **përfshihet të drejtën e viktimës për të kërkuar dëmshpërblim ose për të realizuar një kërkesë tjetër në pajtim me një ligji tjetër para një gjykate kompetente**.
- ▶ organet, përfshirë policinë, prokurorinë publike, gjykatat, Ministrinë e Drejtësisë, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore dhe sociale në Maqedoninë e Veriut, janë të detyruara **që personave që kanë të drejtë në kompensim në të holla t'u sigurojnë informacione** në lidhje me atë të drejtë, si dhe për organin kompetent ku ata mund të drejtohen për realizimin e kësaj të drejte.

¹ kompensim në të holla i paguhet viktimës që është shtetas i një shteti anëtar të Bashkimit Evropian dhe do të fillojë të zbatohet nga data e pranimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian.

² në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës, përkatësisë kombëtare ose etnike, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, përkatësisë së një grupi të marginalizuar, gjuhës, shtetësisë, origjinës sociale, arsimit, fesë ose besimit fetar, bindjes politike, bindjes tjetër, aftësisë së kufizuar, moshës, statusit familjar ose martesor, statusit pronësor, gjendjes shëndetësore, cilësisë personale dhe statusit shoqëror ose çdo baze tjetër në realizimin e të drejtave për dëmshpërblim.